

SHEMBULL ILUSTRUES I UDHËZIMIT NR. 37, DATË 10.07.2013 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE GJATË PËRPUNIMIT TË SHËNJAVE TË GISHTAVE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE”

Gjatë muajit Gusht 2013, pranë Drejtorisë së Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, u paraqit shtetasi B.D. Ky shtetas kërkoi të njihej më shumë lidhur me detyrimet ligjore të parashikuara në udhëzimin nr. 37, datë 10.07.2013, pasi, sipas tij po i përpunoheshin të dhënat personale me anë të sistemit biometrik të shenjave të gishtave në institucionin publik në të cilin ai punon.

Sipas pretendimeve të shtetasit B.D, ai si punonjës por edhe kolegët e tij nuk ishin informuar më parë për instalimin dhe më pas përpunimin e të dhënave me anë të këtij sistemi.

Nisur nga fakti që Drejtoria e ÇPLMJ është hartuesi i udhëzimit nr. 37, datë 10.07.2013, kjo e fundit mori kontakte me të ngarkuarin e kontrolluesit, të cilin e orientoi drejtë mbi zbatimin e udhëzimit të sipër cituar.

I ngarkuari në deklaratën e tij konfirmoi se institucioni i tij, mbledh të dhëna personale me anë të sistemit biometrik për kategorinë e subjekteve të dhënave “nëpunës” dhe se për këtë proces nuk kishte deklaruar në formularin e njoftimit të plotësuar dhe dërguar më parë pranë KMDP-së.

Sipas deklaratimit, kontrolluesi kishte instaluar këtë sistem për të bërë vërtetimin e prezencës në punë të nëpunësve dhe se këtë sistem e kishte instaluar pasi kishte deklaruar në formularin e njoftimit.

Gjithashtu, kontrolluesi konfirmoi se nuk ishte pajisur me autorizimin pranë Komisionerit për instalimin e këtij sistemi në zbatim të pikës 5 të udhëzimit nr. 37, datë 10.07.2013 “Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të shenjave të gishtave nga institucionet publike”.

Kontrolluesi nuk kishte të hartuar një rregullore të posaçme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, referuar shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 27 në të cilën shprehimisht thuhet: Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie : *“..udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregulloret për sigurinë e të dhënave”*.

Përsa i përket sigurisë dhe politikave të privatësisë (neni 27 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008) kontrolluesi kishte marrë masa të nevojshme lidhur me sigurinë fizike të të dhënave personale.

Të dhënat që mbliidhen përpunohen në mënyre manuale dhe në mënyre kompjuterike. Elementet teknike të sigurisë ishin të garantuara dhe optimale. Dosjet ishin të vendosura në raftë të mbyllura, zyra të kyçura etj.

Në kuadër të implementimit të plotë të udhëzimit nr. 37, datë 10.07.2013 “Për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë përpunimit të shenjave të gishtave nga institucionet publike”, i cili ka si qëllim të tij, përcaktimin e rregullave të detyrueshme nga institucionet publike për mbledhjen dhe përpunimin e shenjave të gishtave të punonjësve për vërtetimin e prezencës në punë, Drejtoria e ÇPLMJ dha disa këshilla për kontrolluesin:

1. Në zbatim të nenit 21, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, kontrolluesi detyrohet të përditësojë formularin e njoftimit lidhur me shtimin e kategorive të të dhënave personale që përpunohen, në këtë rast “të dhëna biometrike”.
2. Në zbatim të pikës 5 të udhëzimit 37, datë 10.07.2013 kontrolluesi duhet të pajiset me autorizim nga Komisioneri pasi të paraqesë vendimin e arsyetuar mbi qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të shenjave të gishtave, masat e sigurisë që do të ndërmerren për përpunimin e tyre, kohën e ruajtjes dhe mënyrën e shkatërrimit ose ndryshimit të tyre, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, dhe në veçanti të drejtën e ruajtjes së jetës private.”
3. Në zbatim të nenit 18 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “... “Kontrolluesi kur mbledh te dhëna personale, duhet ta informoje subjektin e këtyre te dhënave...”” mbi qëllimin e instalimit të sistemit biometrik.
4. Në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 dhe pikës 11 të udhëzimit 37, datë 10.07.2013, kontrolluesi ose kushdo që vihet në dijeni me të dhënat detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.
5. Në zbatim të pikës 12 të udhëzimit 37, datë 10.07.2013, kontrolluesi detyrohet të raportojë një herë në vit pranë KMDP-së mbi mënyrën e realizimit të procesit të përpunimit të shenjave të gishtave.